



Centre for Research,
Documentation and Publication

QENDRA PËR HULUMTIM, DOKUMENTIM DHE
PUBLIKIM

E DREJTA NË REPARACIONE NË KOSOVË

PRISHTINË, KOSOVË

MAJ, 2016

Titulli: E drejta në reparacione në Kosovë

Autor: Nora Ahmetaj

Publikuar: Maj, 2016

Botim i Qendrës për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (QHDP). Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak më shkrim nga ana e botuesit.

Ky punim është subjekt për hulumtime të mëtutjeshme.

Publikuar nga:

Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (QHDP), Besa Kabashi-Ramaj | +386 49 340 693 | +377 45 321 545 | info@crdp-ks.org Adresa: Rr. Shaban Polluzha Nr.7, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës



CHARLES STEWART

MOTT FOUNDATION

Përmbajtja e këtij publikimi pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e autorëve, që janë përgjegjës për faktet dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara këtu. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, jodomsdoshmërisht përfaqësojnë ato të Charles Stewart Mott Foundation.

Përmbajtja

i.Akronimet.....	5
1. E Drejta në Reparacione në Kosovë	6
1.1 Hyrje.....	6
1.2 Rekomandimet.....	7
1.3 Metodologjia	8
2. Normat ndërkombëtare për reparacione.....	8
2.1. Dëmshpërblime apo asistencë sociale?.....	9
3. Shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Kosovë	10
3.1. Të mbijetuarit e krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerëzimit në Kosovë pranojnë asistencë nga Qeveria e Kosovës.....	11
3.1.1 Kush duhet të fajësohet?.....	11
4. Çka e parapriu konfliktin e armatosur më 1999?	14
4.1. Punonjësit e larguar dhe kontributet e papaguara pensionale	15
4.2. Shqiptarët dhe joserbët e Kosovës nuk gjetën drejtësi nën administrimin e UNMIK-ut ..	18
4.3 Kërkimi i drejtësisë përmes gjykatave serbe dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, apo dialog politik i vazhdueshëm ?.....	20
4.3.1 A do t'u sillte drejtësi të gjithëve Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut?	20
5. Institucioni i Kërkim faljes.....	22
5.1. Kompensimet	24
6. Përmbyllje	26
7. Bibliografia	28

i. Akronimet

FSPI–Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor

ICTY- Tribunali Ndërkombëtar për Luftën në ish-Jugosllavi

KS i OKB – Këshilli i Sigurimit i OKB-së

LDB–Lufta e Dytë Botërore

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

DT- Drejtësia Transicionale

OJQ–Organizata Joqeveritare

UNMIK –Misioni i OKB-së në Kosovë

QHDP–Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim

NN - Nomen nescio no:.men

ID – Kartë Identiteti

BE – Bashkimi Evropian

KEDNj–Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

PSSP–Përfaqësuesi *Special i Sekretarit të Përgjithshëm*

DAPK – Departamenti i Administrimit të Pensioneve në Kosovë

IRJ – Ish-Republika e Jugosllavisë

KFOR – Forcat e NATO-s në Kosovë

PAYG - “pay-as-you-go”

GjND – Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

LPB – Lufta e Parë Botërore

1. E Drejta në Reparacione në Kosovë

1.1 Hyrje

Ky është punim që shqyrton implikimet ligjore dhe politike për reparacionet në Kosovë, dhe propozon mënyrat më efikase për të kërkuar kompensim nga Serbia për borxhin për pensionet e papaguara të shumicës së shqiptarëve të Kosovës dhe jo-serbëve. Në Kosovë, para fillimit të konfliktit, pensionet administroheshin nga Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor (BVI e SPI).¹

Për të elaboruar më mirë nocionin e reparacioneve², japim një përshkrim të shkurtër të akteve normative ndërkombëtare, të tilla si e Drejta për Dëmshpërblim dhe Reparacione për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare, të Drejtave të Njeriut dhe shkeljeve të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare dhe historinë e shteteve të prekura që kanë filluar të merren seriozisht me reparacionet. Më pas është analizuar dallimi mes drejtësisë reparative, sipas modalitetit të masave kompensuese dhe politikës sociale. Ajo është shfaqë në shumë raste – si në Kolumbi dhe Kosovë, dhe është në natyrën e detyrimeve të shtetit për t'iu përgjigjur detyrimeve të menjëhershme të cilat konsiderohen si ndihmë sociale pas konfliktit. Nuk ndodh gjithmonë që viktimat të gjejnë paqe, dhe fajtorët të dënohen. Zakonisht, viktimat kërkojnë kompensim nga shteti, si të paaftë për të ngritë padi kundër shkelësve, siç ishte rasti me të mbijetuarit e luftës në Kosovë. Kjo është arsyeja pse pjesa e parë e këtij materiali për diskutim, përbëhet nga një analizë e plotë e reparacioneve të luftës që u janë ofruar viktimave civile të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në formë të ndihmës sociale nga institucionet e Kosovës.

Pjesa e dytë e punimit hedh dritë mbi veprat penale të paraluftës (të drejtave pronësore) kundër popullsisë civile kosovare, si dhe mundësitë për kompensimet-të cilat deri më sot mbeten çështje e një rëndësie më të vogël në krahasim me reparacionet për krime lufte.

E drejta e pensioneve, si një kategori ekonomike dhe ligjore, është e drejtë e patjetërsueshme për pronë dhe e mbrojtur karshi akteve të shumta të ligjeve vendore e ndërkombëtare. Tjetërsimi i një të drejte të fituar në bazë të ligjit, mund të kryhet vetëm në përputhje me ligjin dhe vetëm për interesin e përgjithshëm të justifikuar, por, me kompensim të përshtatshëm (Fetahu 2014).

Qëllimi i këtij punimi është që të hedhë dritë mbi sjelljet e këqija në të kaluarën të regjimit serb kundër shumicës shqiptare dhe popullatës jo-serbe në Kosovë, sa i përket mungesës së pagesës së borxhit për pensionistët e papaguar që nga dhjetori 1998, dhe për të kërkuar modelin më të mirë për reparacione që duhet të kërkohen nga kundërvajtësit - në këtë rast Serbia, gjatë një dialogu të vazhdueshëm. Vetëm pasi të jenë zgjidhur çështje të tilla, dinjiteti i pensionistëve do të riparohet dhe të dyja palët mund të arrijnë progres në dialog.

¹ Adil Fetahu 2016

² Ky term ka filluar të përdoret në Kosovë pas një amendamenti të Ligjit Nr. Law No. 04/L-054, ku gratë e përdhunara janë përfshirë si viktimat civile të luftës në vitin 2012.

Pensionistët e Kosovës kurrë nuk u ndalën së kërkuari një zgjidhje qysh prej përfundimit të konfliktit dhe gjatë mandatit të UNMIK-ut, duke shterur të gjitha mjetet juridike dhe duke ushtruar presion edhe te Qeveria e Përkohshme e Kosovës që të marrë masa politike. Megjithatë, UNMIK-u nuk është ndjerë i detyruar të përgjigjet brenda kompetencave të tij, duke pretenduar se çështja është krejtësisht e natyrës politike.

Saga nuk u ndal këtu, të braktisur nga institucionet e Kosovës të cilat nuk ishin në gjendje as të rregullonin legjislacionin, pensionistët, si palë e dëmtuar vendosën që të kërkojnë drejtësi në kuadër të sistemit të drejtësisë serbe dhe të shterin mjetet juridike atje, por pa sukses. Të refuzuar nga gjykatat serbe dhe të përballur me lojëra politike të autoriteteve serbe, dy çifte arritën ta dërgojnë rastin deri në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, dhe rasti i çiftit Grudic mbizotëroi në vitin 2012. Ky rast panikoi Serbinë, e cila mori hapa regresivë dhe ndryshoi legjislacionin në dëm të të dëmtuarve - në këtë rast shqiptarëve të Kosovës, boshnjakëve dhe turqve, ndërkohë që për gati 17 vjet që nga fundi i konfliktit në vitin 1999, Serbia asnjëherë nuk e ndali pagesën e kontributeve pensionale të serbëve dhe malazezëve në Kosovë.

Sipas fjalëve të kryetarit të Sindikatës së Pensionistëve të Kosovës Riza Shala; *“Serbia ka një detyrim ligjor për të paguar pensionet e papaguara, pavarësisht faktit nëse ka të holla në Fond apo jo. Fondi nuk është në pyetje këtu. Serbia nuk e ka kryer detyrimin e saj ligjor”*.

Megjithatë, ka shumë pak gjasa që ndonjë iniciativë e re në shkallë të gjerë për kompensimet do të ndërmerret në lidhje me këto lloje të veçanta të shkeljeve pronësore, përveç nëse komuniteti ndërkombëtar vendos t'i bëjë presion Serbisë për të përmbushur kërkesat e pensionistëve dhe që të sigurojë kompensimet ose një lloj faljeje formale.

1.2 Rekomandohet:

- † Që Qeveria e Serbisë moralisht, ligjërisht, politikisht dhe financiarisht të jetë përgjegjëse për të kompensuar borxhin për pensionistët e papaguar nga fundit i vitit i vitit 1998;
- † Provat tregojnë se shqiptarët e Kosovës dhe punonjësit e tjerë joserbë u diskriminuan në bazë të statusit të tyre etnik minoritar, dhe si të tillë, kompensimi i tyre duhet bërë në përputhje me rrethanat, dhe të përfshijë jo vetëm shumën e saktë të pensionit të papaguar, por edhe dëmin moral për shkak të diskriminimit të pësuar dhe normat e interesit;
- † Që Serbia duhet të përcaktohet për ta pastruar të kaluarën nëse dëshiron të largohet nga pozicioni i saj i izoluar në rajon e më gjerë, në mënyrë që të konsiderohet si partnere serioze dhe anëtare e barabartë e bashkësisë ndërkombëtare;
- † Që Qeveria e Kosovës të marrë parasysh ndryshimet në kornizën ligjore ekzistuese dhe të fillojë një reformë të skemave pensionale dhe përfitimeve të tjera që paguhen nga buxheti i shtetit. Kërkohet hartimi i një ligji të vetëm për sistemin bazë të pensioneve – që do të rregullojë të gjitha skemat e pensioneve dhe të paaftësisë, kontribuuese dhe jokontribuuese.

- † Që Qeveria e Kosovës të përgatitet mirë para se të hyjë në dialogun teknik për çështjen e borxhit të Serbisë për pensionet. Ajo duhet të përfshihet me vendosmëri jo vetëm pse është në interesin e shtetit, por duhet vërtet të përgatisë dokumentacionin përkatës dhe të hyjë në dialog me argumente të forta, në emër të qytetarëve.
- † Të dyja palët, Kosova dhe Serbia duhet të pajtohen qartazi për një mirëkuptim të ndërsjellë. Gjithçka lidhet me dialogun.
- † Që bashkësia ndërkombëtare dhe BE-ja në veçanti të insistojë që Serbia të ballafaqohet me problemin e borxheve dhe kontributeve pensionale, dhe jo ta kategorizojë çështjen si më pak të rëndësishme.

1.3 Metodologjia

Ky punim, rekomandimet dhe përmbyllja që përmban, janë të bazuara në:

- Një rishikim të gjerë të literaturës përkatëse akademike për reparacione, raportet e organizatave të shoqërisë civile ndërkombëtare dhe vendore, mediat, dhe analizat e kujdesshme të ligjeve aktuale të kategorive të luftës në Kosovë dhe Serbi.
- Rishikimi i normave ndërkombëtare, standardeve dhe udhëzuesve që kanë të bëjnë me reparacione si dhe praktikën e mira në lidhje me programet e reparacioneve të viktimave dhe përpjekjet e drejtësisë tranzicionale në kontekstet pas konfliktit në Kosovë dhe më gjerë.
- Diskutimi në fokus grupe është organizuar me pjesëmarrës nga këto institucione: Sindikata e Pensionistëve të Kosovës, Lidhja e Pensionistëve të Kosovës, Federata e Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës, Gratë Pensioniste; përfaqësues, një avokat dhe ekspertë të pensioneve.

2. Normat ndërkombëtare për reparacione

Ideja për të ofruar reparacione për viktimat e llojeve të ndryshme të dëmeve nuk është e re. “Aristoteli, në librin V të Etikës së Nikomahut, ka artikuluar atë që nuk ishte sigurisht një pikëpamje origjinale edhe në atë kohë, sipas të cilit, “drejtësia rektifikuese” kërkon që gjyqtari të “barazojë me anë të dënimit, duke marrë nga të ardhurat e sulmuesit”³. Në fushën e praktikës nga ana tjetër, Traktati i Vestfalisë, i nënshkruar në vitin 1648, ka përfshirë edhe një referencë të zhdëmtim. Sipas Traktatit “përqendrimi në kërkesat për reparacione dhe zhdëmtim është i lidhur me një ndryshim themelor në të drejtën ndërkombëtare ndaj gjendjes së rëndë të viktimave gjatë konflikteve”⁴. Megjithatë, ishte Lufta e Dytë Botërore dhe vetëm pasi komuniteti ndërkombëtar dëshmoi Holokaustin që shkaktoi vendimin që tmerre të tilla në shkallë globale mos të ndodhin sërish. Kjo shënoi një periudhë të paparë të mizorive të drejtave të njeriut, kur viktimat dhe përfaqësuesit e tyre kërkuan drejtësi.

³ Greiff, Pablo De. “Dealing with the past and Transitional Justice Creating Conditions for Peace, Human Rights and the Rule of Law, ‘Reparations and the Role of International Cooperation. faqe 49.

⁴ Ellis, Mark S., and Elizabeth Hutton. "Policy Implications of World War II Reparations and Restitution as Applied to the Former Yugoslavia." *Berkeley Journal of International Law* 20, no. 1, 342

Holokaustin dhe shumë mizori që pasuan LDB, shtynë komunitetin ndërkombëtar në përgjithësi, dhe, Komisionin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në veçanti, për të udhëhequr procesin dhe për të hartuar Parimet Themelore dhe Udhëzimet për të Drejtën për Reparacione dhe Kompensim për Viktimat e Shkeljeve të Mëdha të së Drejtës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, si dhe Shkeljeve të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. Në këtë drejtim, disa ekspertë të pavarur kanë punuar në zhvillimin e parimeve, sipas të cilit dokumenti, në formën e një rezolute, është miratuar unanimisht nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. Të gjithë anëtarët e organizatës e mbështetën.⁵ Më 16 dhjetor 2005, Parimet Themelore dhe Udhëzimet janë miratuar dhe shpallur nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 60/147.⁶ Sipas kësaj rezolute, reparacionet përfshijnë të drejtat për zhdëmtim, kompensim, rehabilitim, satisfaksion dhe garanci për mospërsëritje.⁷

Në dy dekadat e fundit, shtetet kanë qenë të angazhuara në politikën për reparacione për arsye të ndryshme politike dhe ekonomike, duke përfshirë edhe njohjen se padrejtësia apo mizoria vazhdon të ndikojë qytetarët që ishin viktimizuar. Disa udhëheqës në të kaluarën shkuan edhe më tej dhe kërkuan falje edhe për arsye morale, duke reflektuar një vetëdije se padrejtësitë historike të kryera nga paraardhësit e tyre mund të ndikojnë të tashmen⁸, kështu që dinjiteti i viktimave duhet të rivendoset.

2.1. Reparacione apo asistencë sociale?

Është thelbësore që autorët e krimit (shkelësit) të dënohen, ose nën një amnisti të ofrojnë një kërkim falje si aktin më të lartë moral ndaj viktimave, për krimet e tyre të kryera në të kaluarën. Megjithatë, siç duket shpesh në praktikë, viktimat nuk gjejnë domosdoshmërisht drejtësi as dënim të autorëve. Në shumicën e rasteve, viktimat e padrejtësive historike shpesh kërkojnë reparacione nga qeveritë, dhe herë pas here ata i marrin ato. Programet më të njohura të reparacioneve të ofruara për viktimat deri më tani janë reparacionet për viktimat e Gjermanisë naziste, dhe reparacionet për amerikanët japonezë, të cilët ishin ndaluar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara gjatë Luftës së Dytë Botërore.⁹ Marrëdhënia në mes të 'ndihmës sociale' dhe 'reparacionet/kompensimet' në kontekstin e drejtësisë tranzicionale (DT) është dëshmuar të jetë çështje shqetësuese dhe deri tani i është ekspozuar tensioneve themelore, jo vetëm në teori por edhe në praktikë.

Peter J. Dixon në punimin e tij krahasues për Reparacione, Asistencën dhe Përvojën e Drejtësisë: Mësime nga Kolumbia dhe Republika Demokratike e Kongos, përshkruan tensionet

5 United Nations. General Assembly. *Basic Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law*. 60/147 ed. Vol. Resolution. <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RemedyAndReparation.aspx>. Accessed on February 2.2016.

6 Ibid

7 United Nations. General Assembly. *Basic Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law*. 16 dhjetor 2005.

<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RemedyAndReparation.aspx>, Aksesimi më 3 shkurt 2016. Pikat 19-23.

8 Wolfe, Stephanie. *The Politics of Reparations and Apologies*, Volume 7, Springer Science+Business Media New York 2014. faqe 47

9 Posner, Eric A. "Reparations for Slavery and Other Historical Injustices." *Chicago Unbound*, 2003, faqe 689.

mes vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për reparacionet në Republikën Demokratike të Kongos dhe programit për reparacione për viktimat e konfliktit të vet të armatosur në Kolumbi, si një linjë e paqartë mes reparacioneve dhe ndihmës dhe se si funksionon kjo në praktikë”¹⁰. Të dy programet, sipas tij, duken të ngjashme në formë, me proces të ngjashëm të shpërndarjes së reparacioneve për të ofruar koncepte të ngjashme të përgjegjësisë dhe njohjes të viktimave. Megjithatë, gjithmonë do të ketë lloje të dhunës dhe nevoja të paparashikueshme që mund të bien jashtë programeve të reparacioneve.¹¹ Përplasjet e ngjashme, reparacionet kundrejt ndihmës sociale dhe implikimet ligjore kundrejt implikimeve politike në kontekstin e Kosovës, dhe se sa janë të lidhura me viktimat civile dhe shkelësit, do të diskutohen në analizën në vijim.

3. Shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Kosovë

Në konfliktin e Kosovës, bashkësia ndërkombëtare dëshmoi disa nga shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në, zhvendosjet e detyruara, përdhunimin masiv të grave, arrestimet arbitrare, plaçkitjen dhe shkatërrimin e pasurisë private dhe publike, torturat, përdorimin e njerëzve për mburoja, dhe trajtime të tjera çnjerëzore. Këto ishin akte që kanë ndodhur para dhe gjatë bombardimit të Serbisë në mes 2 marsit dhe 10 qershorit 1999.¹² Rreth 90% e popullsisë kosovare shqiptare është zhvendosur nga Kosova gjatë kësaj periudhe, ku vrasjet arbitrare u ekzekutuan në radhë të parë nga policia serbe, nga forcat paramilitare dhe ushtarake kundër tyre.¹³ Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare - një OJQ që ka dokumentuar shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë, numri i shqiptarëve të Kosovës të vrarë gjatë kësaj periudhe tejkalon 10,812.¹⁴ Megjithatë, shpërbërja dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut të popullsisë shqiptare çuan në një konflikt të armatosur në fillim të 1990-ve. Së pari, konflikti filloi me largimin e punëtorëve dhe mësimdhënësve shqiptarë nga punët e tyre, vendosja e aparteidit në shkolla, përcjellë me konfiskimin e fondit pensional dhe invalidor dhe kursimet personale në bankat jugosllave, etj.

Kthimi i personave të zhvendosur brenda vendit pas konfliktit të 1990s dhe reparacionet, në formë të ndihmës sociale që u jepej dhe ende u jepet të mbijetuarve të konfliktit nga ana e Qeverisë së Kosovës, nuk janë mjete të mjaftueshme për të sjellë rehabilitimin e plotë social dhe kohezionin në shoqëri. Edhe pse disa individë në të dy anët e ndarjes janë duke u përpjekur për të zgjidhur problemet në mënyrë të pavarur, ekzistojnë pengesa serioze që parandalojnë një llogaridhënie të plotë për veprimet e këqija në të kaluarën, dhe të ndikojnë në përmirësimin e një marrëdhënie më të qëndrueshme paqësore me respekt të ndërsjellë e dinjitet. Zhdëmtimi i çfarëdo lloji, mbetet një nga pengesat kryesore për t'u zgjidhur mes shqiptarëve dhe serbëve, në mënyrë që të ndodhë kompromisi.

10 Dixon, Peter J. "Reparations, Assistance and the Experience of Justice: Lessons from Colombia and the Democratic Republic of the Congo." *IJTJ International Journal of Transitional Justice*, 2015.

<http://ijtj.oxfordjournals.org/content/early/2015/12/28/ijtj.ijv031.abstract>.

11 Ibid

12 Belgrade, *Victims' Right to Reparation in Serbia and the European Court of Human Rights Standards 2014/2015 Report*. Report. Belgrade, Serbia: Humanitarian Law Center, 2016

13 Ibid

14 Ibid

Çështja e humbjeve njerëzore dhe ekonomike dhe në çfarë mase ato janë të mbrojtura është një çështje shumë komplekse, e cila ka prekur të gjitha komunitetet në Kosovë para dhe pas konfliktit. Ajo ndikon në të gjitha aspektet e jetës në një shoqëri që mbetet thellësisht e ndarë në vija etnike dhe të identitetit. Në periudhën midis fundit të konfliktit, në qershor të vitit 1999, dhe nënshkrimit të shpalljes së pavarësisë, më 17 shkurt 2008, ato linja etnike kanë mbetur të rrënjosura thellë.

3.1. Të mbijetuarit e krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerëzimit në Kosovë pranojnë asistencë nga Qeveria e Kosovës

3.1.1 Kush duhet të fajësohet?

Në dinamikën në mes *reparacioneve* kundrejt *ndihmës sociale*, në Kosovë, sistemi i reparacioneve është projektuar në formë të ndihmës sociale, me synim rikthimin e dinjitetit të të mbijetuarve, si dhe plotësimin e disa nevojave elementare të të mbijetuarve dhe kategorive të luftës, siç janë adresuar në ligjin aktual Nr 4/L-054.¹⁵ Por këtij ligji nuk i është dhënë forma e procedurave themelore për reparacione, ku “prokuroria duhet të përcaktojë faktet përkatëse në standardin ‘përtej dyshimit të arsyeshëm’.¹⁶

Njohja dhe ndihma e këtyre grupeve u adresua fillimisht nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), me Rregulloren Nr. 2000/66, miratuar më 21 dhjetor të vitit 2000, një vit pas konfliktit. Titulli i plotë është: “Rregullorja nr. 2000/66 mbi Përfitimet për Invalidët e Luftës dhe për më të afërmit e atyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë”. Vetëm më 21 janar 2012, Ligji Nr. 4/L-054 për “Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre”, u miratua nga Parlamenti i Kosovës.¹⁷

Anëtarët e familjeve të viktimave civile dhe personave të pagjetur, si dhe të afërmit e dëshmorëve dhe kategorive të tjera të përfshira në Ligjin Nr. 4/L-054 dhe që aplikuan për të fituar qasje në përfitimet që parashikon ky ligj, u kërkuan për të ndjekur procedurën dhe për të sjellë provat e humbjeve të tyre, dhe/ose dëmtimin e tyre fizik që kanë pësuar. Një konfirmim i siguruar nga një OJQ lokale e specializuar dhe e akredituar është dashur ta dokumentojë këtë; për shembull, personi NN ka pësuar dëme të rënda dhe abuzime para se ai/ajo të ketë fituar qasje në përfitimet sipas këtij ligji. Përndryshe, të mbijetuarit nuk kanë ndjekë qasje ligjore, siç sugjerohet në Parimet e Reparacioneve dhe procedurat e saj ku thuhet, “*Aplikuesi duhet të ofrojë dëshmi të mjaftueshme të lidhjes shkakësore midis krimit dhe dëmit të pësuar, në bazë të rrethanave të veçanta të çështjes*”¹⁸. Edhe pse qëllimi i regjimit ishte që të shkatërrojë të gjitha provat e krimeve të veta, ka pasur, megjithatë, prova të mjaftueshme që të mbijetuarit e Kosovës mund të kishin sjellë në sallën e gjyqit. Megjithatë, të mbijetuarit nuk mund të imagjinonin të kërkojnë drejtësi në sistemin juridik të Serbisë. Në përcaktimin e standardit të

¹⁵ Ligji Nr. 04/L-054, Kuvendi i Kosovës. (2011) (i miratuar)

¹⁶ “Order for Reparations.” International Criminal Court. <https://www.icc-cpi.int/iccdocs/doc/doc1919026.pdf>

¹⁷ Centre for Research, Documentation and Publication (CRDP). *Monitoring of Law No. 4/L-054 “On The Status And The Rights of the Martyrs, Invalids, Veterans, Members of Kosovo Liberation Army, Civilian Victims of War and Their Families”*. Prishtina: CRDP, 2014. Faqe 57. <http://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2014/03/2014-raporti-mbi-ligjin-WEBFINAL.pdf>

¹⁸ “Order for Reparations.” International Criminal Court. <https://www.icc-cpi.int/iccdocs/doc/doc1919026.pdf>

dukur të procedurave për reparacione "faktorë të ndryshëm të veçantë për rastin duhet të merren parasysh, duke përfshirë vështirësitë që viktimat mund të hasin në sigurimin e provave në mbështetje të kërkesës së tyre për shkak të shkatërrimit ose pamundësisë së provave"¹⁹.

Shumica e të mbijetuarve shqiptarë të Kosovës nuk kanë menduar dy herë kur kanë zgjedhur për të sjellë prova dhe ngritë paditë brenda Kosovës kundrejt sistemit juridik serb. Kosova ishte nën protektoratin e OKB për gati 9 vjet deri sa shpalli pavarësinë nga Serbia në vitin 2008. Statusi i saj politik vazhdon të sfidohet nga Serbia. Si pasojë e konfliktit, komuniteti ndërkombëtar dhe UNMIK-u sugjeroi që reparacionet për të mbijetuarit e konfliktit të Kosovës duhet të jepen në formë të ndihmës sociale dhe të financohen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Përfundimisht, në kuadër të Ligjit aktual Nr. 4/L-054, "kategoritë e reja sociale që u shfaqën në shoqërinë e Kosovës së pasluftës, ishin rezultat i konfliktit të armatosur të vitit 1999"²⁰, dhe ky ligj përfshin "invalidët dhe viktimat civile të cilët u plagosën si rezultat i konfliktit, si dhe anëtarët e familjeve të të mbijetuarve, të plagosurve, dhe të pagjeturit".²¹ Përfitimet e përshkruara me Ligjin Nr. 4/L-054 mbështesin jo vetëm të mbijetuarit, por edhe familjet e tyre. Ligji është projektuar, jo vetëm për të njohur vuajtjet që të mbijetuarit kanë përjetuar gjatë konfliktit, por edhe për të siguruar mbështetje për nevojat themelore të tyre, traumat dhe dëmet financiare.²² Edhe pse ligji nuk i ka plotësuar tërësisht kërkesat e atyre që kanë nevojë, dhe ka qenë i pamjaftueshëm, ai u ka shërbyer të mbijetuarve më mirë se asgjë.

Kërkimi i drejtësisë në kuadër të sistemit gjyqësor të Serbisë nuk ka qenë një zgjidhje e preferuar për të mbijetuarit shqiptarë të Kosovës, dhe për këtë arsye, familjet kosovare të viktimave kanë mbetë "të kënaqur" me mbështetjen financiare²³ që është siguruar nga institucionet e Kosovës. Një numër i konsiderueshëm i të mbijetuarve shqiptarë dhe familjarët e tyre të cilët kanë kaluar nëpër trauma gjatë konfliktit, besonin fort se të merresh me institucionet e sistemit të drejtësisë serbe dhe të dëshmosh viktimizimin brenda sistemit të drejtësisë serbe ka qenë një akt i pamendueshëm. *Në përcaktimin e standardit të dukur të provës në procedurat për reparacione, faktorë të ndryshëm të veçantë me rastin, duhet të merren parasysh, duke përfshirë vështirësitë që viktimat mund të hasin në marrjen e provave në*

¹⁹ Ibid

²⁰ Ligji nr. 04/L-261, Kuvendi i Kosovës, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-261_a.pdf (2014) (enacted)

²¹ Këta individë nuk janë menjëherë të njohur (përveç në rastet e lëndimit të dukshëm fizik), dhe ata lehtë asimilohen me pjesën tjetër të popullsisë. Jetët e tyre të përditshme nuk janë dukshëm të ndryshme, dhe ata përballen me të njëjtat probleme sociale, financiare dhe politike si kosovarët e tjerë. Kështu, njerëzit që i përkasin këtyre grupeve të pasluftës janë harruar shpesh në mes të problemeve të tjera të panumërta sociale të Kosovës. Megjithatë, nevoja e tyre për ndihmë kuptimplotë psiko-sociale dhe ekonomike është urgjente. Njohja dhe ndihma e këtyre grupeve është drejtuar fillimisht nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), me Rregulloren nr 2000/66, miratuar më 21 dhjetor, 2000. (titull i plotë: "Rregullorja nr. 2000/66 mbi Përfitimet për Invalidët e Luftës dhe për më të afërmit e atyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë."). Më 21 janar 2012, Ligji Nr 4/L-054 për "Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre", u miratua nga Parlamenti i Kosovës, <http://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2014/03/2014-raporti-mbi-ligjin-WEBFINAL.pdf>, faqe 57. (Miratuar)

²² Centre for Research, Documentation and Publication (CRDP). *Monitoring of Law No. 4/L-054 "On The Status And The Rights of the Martyrs, Invalids, Veterans, Members of Kosovo Liberation Army, Civilian Victims of War and Their Families"*. Prishtina: CRDP, 2014. faqe 57. <http://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2014/03/2014-raporti-mbi-ligjin-WEBFINAL.pdf>

²³ Neni 1 i Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre: Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është që të përcaktojë statusin dhe mbështetje financiare nëpërmjet pensione dhe përfitimet të veçanta për kategoritë e luftës të dala nga UÇK-ja, që me kontributin dhe sakrificën e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendit, Ligji nr 04/L-054, Kuvendi i Kosovës. (2011) (në fuqi)

*mbështetje të kërkesës së tyre për shkak të shkatërrimit ose pamundësisë së provave.*²⁴ Fakt është se një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve të Kosovës të cilët u detyruan të largohen nga Kosova, kartat e tyre të identitetit, dhe dokumentacionet tjera përkatëse u janë marrë nga forcat serbe dhe u janë shkatërruar.

Përfundimisht, nëse do të kishte të mbijetuar të guximshëm mjaftueshëm për të paraqitë padi, ata mund dhe duhet të kishin bërë më shumë për të kërkuar drejtësi, duke siguruar prova për gjykatat në Serbi, dhe duke shtjerrë të gjitha mjetet juridike. Pavarësisht nga fakti se sistemi i drejtësisë serbe është me të meta dhe i korruptuar, sipas organizatave ndërkombëtare dhe vendore që monitorojnë punën e sistemit të drejtësisë atje, megjithatë, të mbijetuarit e Kosovës humbën mundësinë për të sfiduar sistemin e drejtësisë serbe. Në këtë mënyrë, jo vetëm që shansi për të fituar rastin, nëse vërtetohet mirë, do të kishte qenë i lartë, por ata (pretenduesit e mundshëm) do të kishin fituar reparacione financiare nga Serbia (si shkelëse). Si pasojë, dinjiteti i të mbijetuarve kosovarë do të ishte riparuar dhe vuajtjet e tyre do të ishin njohur. Nga ana tjetër, qeveria serbe do të kishte përfituar ndërkombëtarisht duke u pranuar si një partner serioz në anëtarësimin e saj në familjen e BE-së.

Në kundërshtim me këtë skenar, të mbijetuarit shqiptarë të Kosovës dhe të mbijetuarit e tjerë nuk diskutuan kurrë seriozisht shterimin e të gjitha mjeteve juridike në sistemin juridik të Serbisë, ngaqë ata fuqimisht besonin se duke qenë shqiptarë të Kosovës, shanset e tyre për të marrë drejtësi në Serbi ishin të papërfillshme. Ka pasur shumë pak raste të suksesshme kur të mbijetuarit e Kosovës të përfaqësuar nga OJQ-të e të drejtave të njeriut të cilat dokumentuan krimet e luftës dhe prezantuan viktimat në gjykatat serbe, siç është familja Bogujevci nga Podujeva.

Është e vështirë të imagjinohet zhdëmtimi dhe reparacionet pa përgjegjësi. Urdhri i reparacioneve Nr. 6, sipas standardit dhe barrës së provës 22 sugjeron se: *“Në procedurën për reparacione, aplikuesi duhet të ofrojë dëshmi të mjaftueshme të lidhjes shkakësore midis krimit dhe dëmeve të pësuar, në bazë të rrethanave të veçanta të rastit”*.²⁵ Në Kosovën e pasluftës, marrëdhëniet Kosovë-Serbi ishin të stagnuara dhe asnjëra palë nuk njihte tjetrën, prandaj komuniteti ndërkombëtar ka vepruar si negociator. Negociatat mbi këto pretendime nuk janë me të vërtetë për të kaluarën, por për të ardhmen: *“Në kontrast me nismat e tjera të drejtësisë transicionale, reparacione janë masat e marra në mënyrë të qartë në emër të viktimave, dhe jo në radhë të parë kundër shkelësve”*.²⁶

Ndihma sociale dhe skema e kompensimit të cilat janë të dizajnuara për të mbijetuarit dhe viktimat e luftës si pasojë e konfliktit në Kosovë, janë duke mbuluar vetëm nevojat themelore. Këtu, duhet të bëjmë dallimin në mes përpjekjeve për "reparacione" të bëra nga qeveritë e Kosovës në njërën anë, dhe mungesës së programeve të reparacioneve, që është dashur të

²⁴“ORDER FOR REPARATIONS (AMMENDED).” A PRINCIPLES ON REPARATIONS. Aksesuar më 17 janar 2016. ICC-01/04-01/06-3129-AnxA 03-03-2015 1/20 NM A A2 A3

²⁵ Ibid

²⁶ Greiff, Pablo De. “Dealing with the past and Transitional Justice Creating Conditions for Peace, Human Rights and the Rule of Law, ‘Reparations and the Role of International Cooperation. faqe 50

zhvillohet në mënyrë që të rehabilitohen të mbijetuarit, dhe të integrohen në shoqëri.²⁷ Pablo de Greiff sugjeron se: *“Përfitimet nga reparacionet janë më së shpeshti rezultat i iniciativave relativisht të izoluara që vijnë duke u rritur, e jo nga një plan i projektuar qëllimisht”*.²⁸

Fusha e politikës për reparacione është zgjeruar më tej në vitin 2000, me publikimin e autorit Elazar Barkan i titulluar *Faji i Kombeve*. Qasja e Barkan-it fokusohet në konceptin e të drejtave universale të njeriut dhe moralit. Ai tërheq vëmendjen sikur Karl Jaspers, duke argumentuar se shtetet kanë përgjegjësi morale për të kaluarën e tyre. Barkan ka propozuar një kornizë të re shpjeguese për politikën e reparacioneve, duke argumentuar se kjo prirje e re ndërkombëtare e shteteve që angazhohen në reparacione dhe zhdëmtimi është rezultat i shfaqjes së një "morali neo-iluminist", i cili më tej shpjegon kërkesën që vjen nga brenda shteteve për të vepruar moralisht dhe reflektivisht në njohjen e padrejtësive apo krimeve në të cilat ata janë angazhuar në të kaluarën. Megjithatë, si një fenomen i ri, ai ndryshon nga praktikatat e kaluara për shkak të natyrës vullnetare të politikës për reparacione.²⁹

Për të përfunduar me një ton më pozitiv, përgjegjësia penale individuale i sjell të akuzuarit për shkelje para drejtësisë dhe mund të ketë një efekt parandalues. Për fat të keq, në shumicën dërmuese të rasteve, kjo nuk jep dëmshpërblim, e as nuk e rivendosë dinjitetin e viktimave dhe të mbijetuarve.³⁰

Shtetet e reja të ish-Jugosllavisë dhe liderët e saj nuk i kanë korigjuar padrejtësitë e kaluara duke ndjekur keqbërësit, as nuk kanë bërë përpjekje për të ofruar falje në emër të shteteve të tyre respektive. Llogaridhënia për ish-Jugosllavinë ka qenë e strukturuar vetëm nëpërmjet Tribunalit të Hagës³¹, ndërsa vetë Tribunali i Hagës nuk kishte për qëllim dhe nuk ishte i autorizuar të merret me kompensimin e viktimave.

4. Çka e parapriu konfliktin e armatosur më 1999?

Shpërbërja e Jugosllavisë filloi në fillim të 1990-ve. Në dhjetor të atij viti, zgjedhjet janë mbajtur vetëm në Serbi, pas së cilave Millosheviqi me forcë shkatërroi të gjitha institucionet e Kosovës.³²

Ky fakt dhe autorizimet e tij të mëtejme ligjore për të shtypur të gjitha demonstrimet publike të pakënaqësisë në Kosovë, janë shënuar me mbylljen e mediave në gjuhën shqipe, një imponim i

27 Centre for Research, Documentation and Publication (CRDP). *Needs Assessment of Kosovo Victims*. Publication. Pristina: CRDP, 2012

28 Greiff, Pablo De. "Dealing with the past and Transitional Justice Creating Conditions for Peace, Human Rights and the Rule of Law, 'Reparations and the Role of International Cooperation. faqe 49.

29 Wolfe, Stephanie. *The Politics of Reparations and Apologies, Volume 7*, Springer Science Business Media New York 2014. faqe 2

30 Permanent Representative of Portugal to the United Nations." Letter to President of the Security Council. 18 maj 2012. New York. <http://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/N1235537.pdf>

31 Ellis, Mark S., and Elizabeth Hutton. "Policy Implications of World War II Reparations and Restitution as Applied to the Former Yugoslavia." *Berkeley Journal of International Law* 20, no. 1,353

32 Rregjimi i Sërbisë në atë kohë burgosi liderin e Partisë Komuniste Azem Vllasi dhe lidërsipin e minorëve të Trepçës (Maliqi, 2011).

Beogradit për të miratuar dhe kontrolluar kurrikulat shkollore, në vend të atyre të miratuara nga institucionet e Kosovës, largimin e punëtorëve shqiptarë, e veçanërisht atyre të punësuar në industri dhe administratë publike.³³

Në 1990-91, shumica e punëtorëve shqiptarë të Kosovës ishin të përjashtuar nga sistemi. Nga fillimi i konfliktit në vitin 1998,³⁴ Beogradi pushoi së paguari pensionet për shumicën e kontribuuesve pensional shqiptarë dhe të tjerët jo serbë.³⁵

Në fund të vitit 1998, në Kosovë ka pasur një total prej 86.383 pensionistëve (Fetahu 2016). Kjo çoi shqiptarët e Kosovës për të gjetur mënyra të tjera për drejtësi. Pas vitit 1999, në Kosovën e administruar nga OKB, paraqitësit e parë të kërkesave kanë filluar të ngritin padi në kuadër të sistemit ligjor të Kosovës.³⁶ Edhe pse disa nga pretenduesit ishin bindës, asnjë rast pozitiv nuk është finalizuar.

4.1. Punonjësit e larguar dhe kontributet e papaguara pensionale

Situata me punëtorët e administratës nuk ishte më e mirë se ajo e sektorit të arsimit, përfshirë degët legislative dhe ekzekutive të Krahinës Autonome të Kosovës më pas. Në çdo pozicion të mundshëm që mbanin shqiptarët e Kosovës, u kërkohej të nënshkruanin betimin e besnikërisë ndaj regjimit të ri, në mënyrë që të ruanin vendet e tyre. Si një shenjë e tradhtisë ndaj regjimit, dhe në solidaritet me çështjen kombëtare (për të mos iu bindur masave të tilla diskriminuese), shumica e shqiptarëve nuk pranuan të nënshkruajnë betimin e besnikërisë, rrjedhimisht humbën punët e tyre.

Para konfliktit të vitit 1998, Kosova ishte e mbuluar nga sistemi i pensioneve të Jugosllavisë, ky ishte sistemi “pay-as-you-go” (PAYG), në të cilin punëtorët e atëhershëm dhanë një kontribut në fondin e pensional, dhe këto kontribute u përdorën për të paguar përfitimet për pensionistët aktualë. Nivelet e pensioneve u përcaktuan nga një formulë në bazë të viteve të shërbimit dhe të nivelit të pagave. Deri në vitin 1989, sistemi ishte i decentralizuar, dhe Kosova kishte një fond pensional të pavarur që mbledhte kontributet dhe paguante përfitimet. Megjithatë, sapo erdhi në pushtet, në vitin 1989 Millosheviçi centralizoi këto funksione në

33 Pula, Besnik. "The Emergence of the Kosovo "parallel State," 1988–1992." *The Journal of Nationalism and Ethnicity*, 2004th ser., 32, no. 4 (23 janar 2007).

<http://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/0090599042000296131>.

34Në vitin 1989, Millosheviçi mblodhi 1 milion serbë, në vendin e betejës së Kosovës, shfuqizoi autonominë e Kosovës dhe vuri krahinën nën kontroll të Sërbisë. Aktivistët shqiptarë të drejtave të njeriut në Kosovë thonë se më shumë se 100,000 të punësuar shqiptarë kanë humbur punët e tyre që nga viti 1990. Shkollat e mesme dhe universiteti kanë ndalë kurset mësimore në gjuhën shqipe dhe futën në kurikula një program të ri serb. Policia dhe zyrtarët tjerë shtetërorë apo funksionarët janë importuar nga Beogradi. Shih këtu http://articles.philly.com/1992-10-16/news/25997683_1_kosovo-albanians-ibrahim-rugova-kosovo-s-albanian

35 Gubbels, John, David Snelbecker, and Lena Zezulin. *The Kosovo Pension Reform: Achievements and Lessons. Report*. World Bank. <http://siteresources.worldbank.org/SOCIALPROTECTION/Resources/SP-Discussion-papers/Pensions-DP/0707.pdf>

36Rregullorja e UNMIK-ut 2001/35 për pensionet në Kosovë, e cila ka dhënë bazën legislative për Shtyllat II dhe III (Shtylla II: Skema e kontributeve të përcaktuara, Shtylla III: Skemat vullnetare), ishte akti i parë për rregullimin e politikës pensionale në Kosovë pas vitit 1999. Rregullorja 2002/1510 hedhë themelet legislative për Shtyllën I (Shtylla I: Pensionet Bazike dhe Invalidore dhe Pensionet e Parakohshme për punëtorët e Trepçës), në mënyrë që të lejojë për të tri komponentët e sistemit që të bëhen operacionale më 2002. Në prill të të njëjtit vit, Kuvendi miratoi ligjin nr. 2011/04-L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i cili shfuqizoi Rregulloren nr. 2005/20 dhe Ligjin nr. 03/L-08411. (Grupi për Studime Juridike dhe Politike, dhjetor 2012).

Beograd, dhe fondi rajonal i Kosovës u nda. Që nga vitit 1989, shumica e punëtorëve kosovarë janë larguar nga pozicionet e punës në sektorin formal. Që nga fillimi i konfliktit në vitet 1998-1999, Beogradi pushoi së paguari pensionet për shumicën e kontribuuesve të fundit.³⁷

Në punimin e tyre për diskutim, një grup prej tre ekspertësh botëror (Gubbels, Snelbecker, Zezulin) që më vonë ndihmuan ekspertët vendorë kosovarë në ngritjen e sistemit të fondit pensional në Kosovë, e përshkruan kronologjinë e sistemit si ishte, dhe se si ai evoluoi në një sistem më të avancuar pensional evropian. Sipas tyre: *"Për çdo ish-pensionist, ekzistonin të dhëna në një bazë të dhënash kompjuterike (programuar në Unix në një PC) që përfshinte datën e lindjes, adresën, dhe informacione të tjera personale."* Megjithatë, shumica e këtyre të dhënave nuk ekzistojnë më, *"që nga koha e bombardimeve të NATO-s, një raketë e NATO-s goditi ndërtesën e postës dhe telekomunikacionit tjetër në Fondin e Sigurimeve Shoqërore në Prishtinë."*³⁸ Po ashtu gjatë bombardimeve zjarri shkatërroi format M139 dhe M2, por M4 dhe PS shpëtuan meqë ishin një kat më poshtë. *Si rezultat i kësaj, ekzistonin ende informacione të vlefshme mbi datat e lindjes të kontribuuesve më të vjetër në sistemin (Format PS), por jo edhe të kontribuuesve të rinj me sistemin (M1 dhe M2). Në formën M4 ka egzistuar një bazë e mirë e të dhënave të kontribuuesve të fundit, ngase punëdhënësit kishin dërguar këto informacione në Fondin Pensional, por nuk kanë mundur informacionet mbi fillimin dhe ndalimin e datave të punësimit (format M1 dhe M2)."*⁴⁰ Ndërprerja e pagesës së pensioneve të pensionistëve kryesisht shqiptarë dhe boshnjakë të Kosovës, pa dhënë ndonjë arsye për ndërprerje, jo vetëm që është një formë diskriminimi në baza etnike, por është e paligjshme dhe shkel të drejtat e pronësisë së njerëzve, të garantuara dhe të mbrojtura nga ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Pensionet nuk janë fonde buxhetore të qeverisë, por kontributet e mbledhura për vite me radhë, dhe duhet të kompensohen në përputhje me rrethanat.⁴¹

Struktura e veçantë drejtuese e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, nën protektoratin e OKB-së, ishte ndryshe nga qeverisja e pothuajse çdo vendi sovran. Ndërprerja e pagesave të pensioneve gjatë konfliktit në fund të viteve 1990 e bëri më të lehtë braktisjen e sistemit të vjetër të pensioneve dhe fillimin e një sistemi të ri. Tensionet e vazhdueshme etnike lanë çështjen e detyrimeve të Beogradit për pensionet që të trajtohet gjatë negociatave në vitet

37 Gubbels, John, David Snelbecker, and Lena Zezulin. *The Kosovo Pension Reform: Achievements and Lessons. Report.* World Bank. <http://siteresources.worldbank.org/SOCIALPROTECTION/Resources/SP-Discussion-papers/Pensions-DP/0707.pdf>

38 Ibid

39 Të dhënat mbi ish-kontribuuesit të cilët nuk kanë arritur moshën e pensionit ishin më pak të kompletuara. Mënyra se si kontributet ishin të regjistruara në sistemin e vjetër është si vijon: Punëdhënësit dërgonin në fondin pensional një Formular M1 duke njoftuar se kur individë kishin filluar punën, dhe një Formular M2 që njoftonte se kur individët janë pushuar nga puna. (M1 dhe M2 Format ishin futur në sistem rreth viti 1968, duke zëvendësuar Format PS që ishin përdorur në vitet e mëparshme. Një Formë M3 është përdorur për të korrigjuar gabimet në M1 dhe M2 Format). Punëdhënësit do duhej të njoftonin fondin pensional në lidhje me nivelin e pagave (nga të cilat kontributet ishin bërë) në mënyrë periodike duke përdorë Format M4. Kur një person arrinte moshën e pensionimit, "Shërbimi Profesional" i fondit pensional vlerësonte historinë e pagave, shpesh duke kontaktuar ish punëdhënësit për të verifikuar nivelet e pagave që punëdhënësit nuk ka ofruar vazhdimisht informacion me formën M4 të fondit pensional. Kjo kishte ofruar liri të konsiderueshme discrecioni në procesin e përcaktimit të nivelit të pensionit (Reforma e pensioneve në Kosovë: Të arriturat dhe Mësimet John Gubbels David Snelbecker Lena Zezulin prill, 2007).

40 Gubbels, John, David Snelbecker, and Lena Zezulin. *The Kosovo Pension Reform: Achievements and Lessons. Report.* World Bank. <http://siteresources.worldbank.org/SOCIALPROTECTION/Resources/SP-Discussion-papers/Pensions-DP/0707.pdf> faqe 12

41 Grudić v. Serbia, No. 31925/08 (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 17 prill 2012) (Dist. file).

e mëvonshme.⁴² Prandaj, çështja e fondeve të pensioneve është planifikuar të sillet në tryezën e bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë në të ardhmen e afërt.

Që nga fillimi, institucionet e Kosovës, konkretisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka insistuar se UNMIK-u duhet të bëjë trysni ndaj Beogradit për të bërë pagesën e borxhit për pensionistët e papaguar. Është vlerësuar se rreth 100.000 pensionistë kosovarë kanë kontribuar në këtë fond, dhe Beogradi i ka përvetësuar kontributet e tyre.⁴³ "Ne e dimë se si ka funksionuar fondi, me një brez që ofronte për brezin tjetër. *Ne gjithashtu e dimë se Qeveria e Serbisë në Beograd aktualisht siguron pensione të qytetarëve të caktuar të Kosovës, në veçanti pjesëtarëve të komunitetit etnik serb*"⁴⁴ Ndërkohë që përfaqësuesit e Lidhjes së Pensionistëve të Kosovës dhe Sindikatës së Pensionistëve të Kosovës konfirmojnë se; përkundër faktit që në fund (1998) nuk ka pasë shumë mjete të grumbulluara, duke marrë parasysh se nga mjetet që vinin në fond, paguheshin pensionet. Megjithatë, Serbia është e detyruar të bëjë pagesën e borxhit për pensionistët e papaguar, por jo edhe për kthimin e Fondit.

Vetëm serbët e Kosovës vazhdojnë të marrin përfitime pensionale nga Beogradi, dhe ka indikacione se një numër i vogël i shqiptarëve kosovarë kanë pasur sukses në marrjen e pensioneve duke mbledhur përfitime përmes Serbisë në baza individuale. Megjithatë, deri më tani kjo ka mbetur një iniciativë individuale për ish kontribuuesit pensional për të luftuar për të drejtat e tyre të pronësisë. Në të kaluarën, disa përpjekje janë bërë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës për të zgjidhur çështjen në mënyrë institucionale, por për fat të keq pa sukses. Ndërsa serbët e Kosovës marrin pensionet, shqiptarët dhe boshnjakët e Kosovës mbeten të vendosur për të luftuar për kontributet e tyre pensionale, pavarësisht nga fakti se drejtësia është duke marrë më shumë kohë sesa pritej. Më pas, disa paditës kosovarë të cilët kanë humbur kontributet pensionale dhe pagesat e tyre pensionale që nga fundi i konfliktit në vitin 1999, kanë filluar veprimet ligjore kundër autoriteteve shtetërore serbe në mënyrë që të kompensohen.

Rreth 11,463 kërkesa janë bërë në Serbi për pagesat e pensioneve të pensionistëve të Kosovës. Sipas autoriteteve serbe, *"gjithsej prej këtyre kërkesave, 8518 nuk plotësojnë dokumentacionin, ndërkohë që kërkesat e 1,442 janë në rregull dhe vetëm pritet të merret vendimi për to"*.⁴⁵

Nga mijëra paditës, dy çifte të Kosovës arritën të sjellin çështjen në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Pas disa viteve të shterimit të të gjitha mjeteve juridike në kuadër të sistemit juridik të Serbisë, çifti Grudić nga Mitrovica - Kosovë, fitoi rastin e parë në rrethin e dytë - Grudić kundër Serbisë (Aplikacioni nr 31925/08) - VENDIM STRASBURG më 17 prill

42 Gubbels, John, David Snelbecker, and Lena Zezulín. *The Kosovo Pension Reform: Achievements and Lessons. Report*. World Bank. <http://siteresources.worldbank.org/SOCIALPROTECTION/Resources/SP-Discussion-papers/Pensions-DP/0707.pdf>, faqe 8

43 Selmanaj, Ibrahim. "Issue of Kosovar Pension and Invalid Fund Misappropriated by Serbia Must Be Resolved." Albanian-Serbian Information Exchange Forum. <http://kosovakosovo.org/issue-of-kosovar-pension-and-invalid-fund-misappropriated-by-serbia-must-be-resolved.html>.

44 Ibid

45 Llapashtica, Liridon. "Serbia 2 Miliardë Euro Borxh Pensionistëve (Serbia Owns 2 Billion Euros to Pensioners)." *Zeri.info*, 8 janar 2014. <http://old.zeri.info/artikulli/24366/undefined>.

2012.46 Si pasojë, ky vendim nxiti autoritetet serbe për të ndryshuar legjislacionin dhe për të bërë atë edhe më të vështirë për paraqitësit e kërkesave individuale që kërkojnë drejtësi.

4.2. Shqiptarët dhe joserbët e Kosovës nuk gjetën drejtësi nën administrimin e UNMIK-ut

Faktet janë që pas pezullimit të paraqitësve të kërkesave për pensione jugosllave, me Rregulloren Nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë, të 22 dhjetorit 2001 dhe me Rregulloren Nr. 2005/20, të 19 prillit 2005, që amandamenton Rregulloren Nr. 2001/35, UNMIK-u themeloi një skemë alternative të pensioneve që siguronte pensionet "bazike" (mosha e vjetër, jo kontribuese) dhe "kursimet" (kontribuese). 47

Kjo skemë, megjithatë, nuk ka zgjidhur çështjen e fondeve të papaguara nga Beogradi para se të filloj konflikti, as nuk ka kërkuar për modalitetet në negociatat me Beogradin për të paguar borxhe për pensionistët e papaguar. Në vend të kësaj, UNMIK-u si një autoritet indiferent në çështje të ndjeshme politike, në mënyrë të vendosur ka qëndruar prapa "përgjegjësive" të veta të cilat kishin për qëllim lehtësimin e një procesi politik.

Paditësi i parë ishte një banor i Kosovës nga komuna e Pejës i lindur në vitin 1938, ai kishte kontribuar për pensionin e tij në fondin pensional të shtetit Republika Federale e Jugosllavisë me titull "Fondi i Pensionistëve dhe Njerëzit me Aftësi të Kufizuara", ku kishte akumuluar të drejtën për një pension që nga data 3 maj 1998. Në ankesën e tij, ai thotë se ka marrë një pension në vlerë prej 180 euro në muaj nga kjo datë deri më 1 dhjetor 1998. Pas kësaj date, pensioni i tij ishte ndërprerë pa ndonjë njoftim paraprak apo shpjegim. 48

Paditësi thotë se pas vendosjes së UNMIK-ut në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB 1244 (1999) ai dhe shqiptarët e tjerë të Kosovës, u ndaluan të marrin këtë pension nga Beogradi, ndërsa serbët e Kosovës kanë vazhduar të marrin këtë pension. 49 Ankuesi pretendon diskriminim në lidhje me pagesën e pensionit. Në mënyrë të veçantë, që serbët e Kosovës rregullisht marrin pensionet nga fondet, ndërsa shqiptarëve të Kosovës u është ndaluar marrja e pagesave.50

Sipas Kryetarit të Sindikatës të Pensionistëve të Kosovës, struktura nacionale e përdoruesve të së drejtës për pension që nga 31 dhjetori 1998 ishte: 61,705 të etnisë shqiptare dhe të tjerë, ndërsa 27,430 ishin serbë dhe malazezë të Kosovës. Serbët dhe malazezët e Kosovës deri më sot janë duke marrë rregullisht pensionet e tyre si nga fondi i Serbisë, ashtu edhe nga fondi i Kosovës, ndërsa pensionistët shqiptarë u shfuqizuan dhe pushuan të marrin pensione që nga dhjetori 1998.

46 Grudić v. Serbia, No. 31925/08 (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 17 prill 2012) (Dist. file).http://www.zastupnik.gov.rs/uploads/cr/presude/u-odnosu-na-rs/grudic-protiv-srbije-p.-br.-31925-08/Grudic_p_3192508_eng.pdf

47 Krasniqi, Tomë. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, 6 qershor 2013, data e adaptimit: 6 qershor 2013 Case No. 08/10 2013, aksesuar më 15 shkurt 2016 http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Cases%20Eng/DC_08-10_ENG.pdf

48 Ibid

49 Ibid

50 Ibid

Në këtë diskriminim në bazë të nenit 14 KEDNJ, Paneli Këshillëdhënës në emër të PSSP-së thekson se: "UNMIK-u nuk kishte fuqi ose kontroll në lidhje me pensionistët serbë që jetonin në Kosovë e që merrnin pensionet e tyre në baza të rregullta nga Beogradi. Kështu, çdo praktikë diskriminuese në përzgjedhjen e përfituesve dhe pagesën e pensioneve nuk mund t'i atribuohet UNMIK-ut dhe për këtë arsye, paneli nuk ka juridiksion *ratione personae* për këtë pjesë të ankesës."⁵¹

Kur i është paraqitur dokumentacioni Panelit Këshillues për të Drejtat e Njeriut (ankesa është paraqitur më 8 mars 2010 dhe është regjistruar në të njëjtën ditë), duket se, më 11 prill 2007, parashtruesi i kërkesës ka adresuar një ankesë në Departamentin e Administratës së Pensioneve në Kosovë (DAPK) - në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës, duke kërkuar pagesën e pensionit të përlogaritur në bazë të ish-sistemit jugosllav. Më 13 prill 2007, DAPK ka dërguar një përgjigje me shkrim për paditësin duke deklaruar se mospagesa e pensionit e përlogaritur përmes kontributeve ishte për shkak të "fondeve të vjedhura nga okupatorët serbë", gjë që përbënte një "problem të pazgjidhur politik" dhe e informonte ankuesin për skemat e pensioneve në proces, të administruara nga DAPK. ⁵²

Rastet e përmendura më lart, shpjegojnë pozicionin vartës të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës vis -a- vis autoritetit të UNMIK-ut, dhe rrjedhimisht dëshmojnë mungesën e qasjes pragmatike të UNMIK-ut për të mirën e qytetarëve të Kosovës. Ndërsa OKB mbante autoritet të plotë politik në nivel qendror dhe lokal, strukturat atëherë ekzistuese të qeverisë do të ishte dashur të dizajnoheshin si ekzekutiv politik.

Paditësi i lartpërmendur së bashku me pensionistë të tjerë shqiptarë të Kosovës, u ndaluan të marrin pensionet e tyre kontribuuese. Edhe pse fondet janë grumbulluar nga kontributet e punonjësve për vite, ato janë "zhdukur". Më pas, sipas tyre deri më sot; "nuk ka fonde të tjera që janë krijuar për pensionistët shqiptarë". Në këtë drejtim, paditësit besonin se UNMIK-u ishte një autoritet për të ndihmuar, dhe duhet të mbahen përgjegjës për "keqmenaxhim".⁵³

PSSP-ja ⁵⁴ në anën tjetër, e hodhi poshtë çështjen mbi bazën se, "UNMIK-u s'kishte asnjë detyrim ligjor për të paguar pensionet për personat të cilët kanë fituar të drejtën e pensionit me anë të institucioneve të tjera". Prandaj, kur paditësi ankohet kundër heqjes së zotërimeve të paditësit, kjo shkelje do t'i atribuohet RFJ-së apo Serbisë dhe, si e tillë, duhet të deklarohet nga Paneli jashtë juridiksionit të tij *ratione personae* ... "Serbia është një palë në KEDNJ që nga viti 2004. ⁵⁵ Për këtë arsye, kjo pjesë e ankesës duhet të shpallet e papranueshme në përputhje me nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/12 për mos-shterje të mjeteve.⁵⁶ Rregullorja nr. 1999/1 thotë shprehimisht se "i gjithë autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv, që ka të bëjë me Kosovën, duke përfshirë edhe administrimin e gjykatave, i takon UNMIK-ut, dhe që ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) [Riza Shala 2016].

⁵¹ Ibid

⁵² Ibid

⁵³ Ibid

⁵⁴Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP)

⁵⁵ Konventa Europiane për të Drejtat e njeriut (ECHR).

⁵⁶ Krasniqi, Tome. The Human Rights Advisory Panel, sitting on 6 June, Date of adoption: 6 June 2013 Case No. 08/10 2013, Accessed February 15.2016 http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Cases%20Eng/DC_08-10_ENG.pdf

UNMIK-u në anën tjetër, nuk ndjehej i detyruar në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 për të "gjetur një zgjidhje" për çështjen e pensioneve në Kosovë, e cila, sipas mendimit të Panelit Këshillëdhënës, mendohej të ishte një çështje politike që do të zgjidhet "në mes të Prishtinës dhe Beogradit me mbështetjen e akterëve ndërkombëtarë". Megjithatë, sipas PSSP, edhe pse Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) parashikon që përgjegjësitë e UNMIK-ut do të përfshijnë lehtësimin e një procesi politik të dizajnuar për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, kjo përgjegjësi nuk mund të interpretohet si një detyrim "për të gjetur një zgjidhje" për problemin e pensioneve..."⁵⁷

Së fundi, PSSP argumenton se paditësi nuk ka ofruar asnjë dëshmi se ka ndërmarrë hapa për të siguruar pagesën e pensionit të tij nga autoritetet serbe; në mënyrë të veçantë ai nuk ka paraqitë një kërkesë kundër Serbisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila, sipas PSSP, do të përbënte një mjet efektiv. Duke pasur parasysh këtë, paneli unanimisht e ka shpallë të papranueshme pjesën e mbetur të ankesës. 58

Ngurrimi i UNMIK-ut për të përmbushur kërkesat e qytetarëve të Kosovës që ishin nën mbrojtjen e tij, është përshkruar më së miri në librin e Wills-it "Mbrojtja e Civilëve" dhe detyrimet e paqeruajtësve për të vepruar kështu, që nga themelimi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, stafi i të cilit gëzonte imunitet të plotë. *"UNMIK-u ka përjetësuar dhe ka krijuar pengesa për mbrojtjen e plotë të të drejtave të njeriut, duke nxjerrë rregullore për t'i dhënë vetes dhe pranisë ushtarake ndërkombëtare (KFOR) imunitet të plotë nga procesi ligjor në Kosovë. Për më tepër, duke e hequr autoritetin vendimmarrës mbi të drejtat civile të rëndësishme nga gjykatat dhe duke vendosur atë në organet administrative nën kontrollin e drejtpërdrejtë të UNMIK-ut, dhe duke ndjekur kurse të ngjashme të veprimit që shërbenin për të eliminuar ose për të kufizuar të drejtat e individëve nga Kosova."*⁵⁹

4.3 Kërkimi i drejtësisë përmes gjykatave serbe dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, apo dialog politik i vazhdueshëm ?

4.3.1 A do t'u sillte drejtësi të gjithëve Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut?

Rasti Grudić kundër Serbisë e ka zanafillën në ankimin (nr. 31925/08) kundër Serbisë dhe është depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga dy shtetas serbë me origjinë boshnjake (më herët banorë kosovarë), Znj Ljutvija Grudić, dikur Klapija, ("aplikanti i parë") dhe Z. Mahmut Grudić ("aplikanti i dytë"), më 24 qershor 2008. 60 Vendimi i Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg detyron shtetin e Serbisë për të paguar pensionet invalidore për qiftin Grudić nga Mitrovica (Kosovës), që aktualisht jeton në Novi Pazar (Serbi), për të gjithë periudhën gjatë të cilës janë

⁵⁷ Ibid

⁵⁸ Ibid

⁵⁹ Wills, Siobhan. Protecting Civilians, The Oxford University Press, 2009, faqe 217

⁶⁰ Grudić v. Serbia, No. 31925/08 (The European Court of Human Rights April 17, 2012) (Dist. file). http://www.zastupnik.gov.rs/uploads/cr/presude/u-odnosu-na-rs/grudic-protiv-srbije-p.-br.-31925-08/Grudic_p_3192508_eng.pdf

ndërprerë pagesat, dhe të vazhdojë me pagesat e mëtejshme të pensioneve (Vendimi nr. 31925/08, të datës 17 prill 2012).

Duke reaguar ndaj vendimit të mësipërm të Gjykatës së Strasburgut, Qeveria e Serbisë (më 12 shkurt 2013), miratoi Planin e Veprimit për zgjidhjen e problemit të pensioneve në territorin e Kosovës dhe Metohisë. Në përputhje me këtë plan, Fondi Republikan për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Serbisë, publikuar më 20 shkurt 2013, në faqen e internetit në sërbiisht "Njoftimi për përfituesit e pensionit nga Regjioni i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë"⁶¹ njofton se është caktuar një afat kohor (60 ditë), së bashku me një listë të dokumenteve dhe dëshmime të nevojshme që do duhej ti bashkëngjitën formularit të aplikimit për vazhdimin e pagesave të pensioneve.

Pas shpalljes së këtij njoftimi, shumë pensionistë nga Kosova kanë paraqitur kërkesat e tyre për vazhdimin e pagesës së pensioneve nga data kur ajo është ndërprerë. Megjithatë, pas shqyrtimit të aplikacioneve, shërbimet profesionale të Fondit të Serbisë kanë arritur në përfundimin se një numër shumë i vogël i kërkesave ishin kompletuar plotësisht. Sidoqoftë, për ata që kishin përfunduar dokumentet e tyre, siç kërkohet, Fondi Republikan për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Serbisë ka filluar lëshimin e vendimeve, ku pothuajse të gjithë aplikuesve u ishin refuzuar kërkesat e tyre për arsye se ata marrin pensione nga UNMIK-u. Shumë aplikues humbën besimin në sistemin e drejtësisë dhe hoqën dorë, ndërsa vetëm ata që ishin më këmbëngulës, personalisht ose nëpërmjet avokatëve të tyre, u ankuan kundër vendimit të shkallës së parë në procedurën administrative të Fondit. "*Shkalla e dytë në pushtet kryesisht refuzoi ankesat si të pabaza dhe la në fuqi vendimin e shkallës së parë, duke ruajtur të njëjtin shpjegim*"...*Dy pensione nuk mund të merren në Republikën e Serbisë!*" Ata e trajtojnë Kosovën si një krahinë autonome brenda Serbisë."⁶²

Kjo nuk është vetëm një formë e diskriminimit në baza etnike, por është gjithashtu e paligjshme, imorale dhe një shkelje e të drejtave të njeriut dhe të pronës, të garantuara dhe të mbrojtura nga ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Fondi i pensioneve nuk është thjesht një mjet buxhetor, por kontributet e mbledhura gjatë viteve dhe ato duhet të kthehen në përputhje me rrethanat.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në praktikën e vet të gjykimit dhe në disa nga vendimet e saj në mënyrë të qartë thekson se, "*e drejta e marrjes së një pensioni është një e drejtë e pronës, në kuptim të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*" (...) dhe arrin në përfundimin: "*se ndërprerja e pagesës së pensionit është shkelje e së drejtës për të gëzuar këtë pronë, si një e drejtë themelore e njeriut e garantuar nga Konventa*."⁶³ Vendimet e autoriteteve serbe, në një anë zvarrisin çështjet përmes procedurave të komplikuar administrative dhe gjyqësore, dhe në anën tjetër, justifikojnë veten para Gjykatës Evropiane për

⁶¹Ky është emri zyrtar i Kosovës në Kushtetutën e Serbisë.

⁶²Fetahu, Adil. "Serbia Po Manipulon Me Pensionet E Pensionisteve Kosovare (Serbia Is Manipulating with the Pension Funds of Kosovo)." *Zemra Shqiptare*. 22 shkurt 2013. http://www.zemrashqiptare.net/news/id_31091/Adil-Fetahu:-Serbia-abuzon-me-pensionet.html

⁶³Grudić v. Serbia, No. 31925/08 (The European Court of Human Rights April 17, 2012) (Dist. file).http://www.zastupnik.gov.rs/uploads/cr/presude/u-odnosu-na-rs/grudic-protiv-srbije-p.-br.-31925-08/Grudic_p_3192508_eng.pdf

të Drejtat e Njeriut në Strasburg, duke pretenduar se do t'i shqyrtojnë rastet një nga një dhe në këtë mënyrë se po operojnë në kuadër të sistemit të drejtësisë. Përveç kësaj, vendimi i autoriteteve serbe është bërë në përputhje me ndryshimin e legjislacionit në Serbi, siç u përshkrua më sipër, dhe arrin në përfundimin se të gjithë ata pensionistë të cilët nuk kanë marrë një pension nga Kosova që nga viti 1999, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për pension. Kjo nuk do të thotë se pensioni i Serbisë do të merret, për shkak të faktit se shumica e jo-serbëve⁶⁴ të Kosovës janë regjistruar në sistemin e Kosovës për të marrë përfitimet. Si pasojë, atyre do t'u refuzohet e drejta për të aplikuar për dy pensione.

Kjo politikë është e padrejtë, pasi fondet janë marrë nga brezat e mëparshëm, të cilët kanë kontribuar në fondin e pensioneve, dhe paditësit duhet të kenë të drejtë për kompensime. Efekti i kësaj drejtësie është i pavlefshëm për pensionistët e Kosovës, ose në raste të caktuara, gati minimal.

Fondi i pensioneve mbetet një çështje e ndjeshme, dhe është e paqartë nëse ajo do të zgjidhet ndonjëherë në nivel shtetëror nga dy qeveritë. Me kërkesa individuale, qytetarët e Kosovës të cilët përpiqen për të marrë pagesën e borxhit të papaguar, mund të presin vite të tëra për drejtësi. Deri atëherë, Qeveria e Kosovës dhe institucionet e saj duhet të negociojnë me Serbinë. Por si?

Serbia, në anën tjetër, duhet të mendoj sërish për qasjen ndryshe ndaj kësaj çështje. Nëpërmjet ndryshimit të legjislacionit në dëm të paditësve të ardhshëm të Kosovës, Serbia tregon se nuk është e gatshme për t'u marrë me keq-bërjet e saja gjatë viteve të 90-ta dhe të shoh përpara. Fakt është se borxhi i Serbisë për qytetarët e Kosovës është i madh dhe se qytetarët e Kosovës meritojnë djersën e ballit të tyre. Nga ana tjetër, është një fakt i pashmangshëm që çështja e borxhit të papaguar të pensionistëve do të jetë një temë shumë e tensionuar në dialogun që po vazhdon.

5. Institucioni i Kërkim faljes

Në kontekstin e reparacioneve që kanë të bëjnë me krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, mund të ketë disa arsye dhe aspekte pse liderët politikë nga Ballkani Perëndimor hezitojnë për të shkëmbyer kërkim-falje të sinqertë si reparacion simbolik, duke lënë anash paketën financiare për reparacionet.

Në bazë të tipologjisë, ka kërkim-falje të ndryshme. Çfarë lloj institucioni është duke thënë "më vjen keq", ose duke ofruar falje? Kërkim-faljet duhet të jepen nga individët, organizatat fetare, udhëheqësit shpirtërorë, qeveritë, dhe krerët e shteteve. Një udhëheqës i mirë dhe i pjekur politikisht, fetar ose shpirtëror mund të jetë ai që guxon të marrë vendime të vështira dhe angazhime që shkojnë përtej politikës ditore. Rasti për kërkim-falje është më bindës kur ka

⁶⁴ Shqiptarët, boshnjakët, turqit, romët

potencial për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve, nëse falja në çfarëdo formulimi, është e sinqertë dhe është e pranueshme për përfituesit.⁶⁵

Mungesa e një lidheshipi vizionar dhe të fortë, periudha e shkurtër kohore që nga fundi i konfliktit, mungesa e të dhënave të duhura për humbjet njerëzore dhe ekonomike, si dhe pronësia e "narrativit vetë-viktimizues" e prodhuar nga lidheshipi politik në të gjithë rajonin, ende e mbytë frymën e debateve të hapura në vendet e ish-Jugosllavisë.

Më 26 mars 2014, OJQ-ja feministe dhe anti-militariste e quajtur "Gratë në të zeza" nga Serbia mbajti një performancë përkujtimore në Sheshin e Republikës në qendër të Beogradit, duke përkujtuar masakrën ndaj civilëve shqiptarë, gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999: *"Sot ne përkujtojmë masakrën ndaj popullatës shqiptare, e cila përveç bombardimeve të NATO-s, i është ekspozuar terrorit të armatosur dhe spastrimit etnik nga regjimi serb. Ne shprehim ngushëllimet tona më të thella dhe solidaritetin me familjet e viktimave, tha Zajovic"*.⁶⁶ Ky ishte deri më tani i vetmi përkujtim dhe nderim i ofruar ndonjëherë për viktimat shqiptare të krimeve të luftës dhe të mbijetuarve, duke lënë anash abuzimet tjera të drejtave të njeriut që kanë ndodhur para konfliktit.

Asnjëherë një falje formale nuk është ofruar nga ndonjë politikan, institucion serb apo udhëheqës fetar deri më tani. Gjatë konsultimeve me të mbijetuarit e konfliktit në Kosovë dhe viktimat civile të luftës për krijimin e Komisionit të së Vërtetës për krime lufte në ish-Jugosllavi, zërat për njohje dhe falje nga kryesit e krimeve apo institucionet e tyre përkatëse ishin vibrant; *"Nëse Serbia mund të dërgojë vetëm një falje publike, kjo do t'i kishte bërë gjërat shumë më të lehta për ne"*.⁶⁷ Një falje publike përfshin një vërtetim të krimeve të kaluara dhe pranim të përgjegjësisë. Disa politikanë nga Serbia, Kroacia dhe Mali i Zi, kanë shkëmbyer kërkim falje individuale për të gjitha krimet e kryera në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, respektivisht.⁶⁸

Megjithatë, nuk është asnjë lider i vetëm serb, që ka kërkuar falje për krimet e kryera kundër shqiptarëve të Kosovës. Këtu duhet të shtohet fakti se udhëheqja e Kosovës nuk është imune ndaj përgjegjësisë për krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur të 1998-2000 ndaj jo shqiptarëve.

65 Cunningham, Michael. *Saying Sorry: The Politics of Apology*, the Political Quarterly Publishing Co. Ltd, 1999, faqe 291.

66 "Women in Black, Apologize Albanians from Belgrade Center." *Kosova Press*, 26 mars 2014.

<http://www.kosovapress.com/en/nacional/women-in-black-apologize-albanians-from-belgrade-center-13410/>.

67 Intervistë me gratë, anëtare të familjeve të të vrarëve nga Rahoveci, 4 dhjetor 2010. <http://www.recom.link/nacional-consultations-with-women-victims-of-war-rahovecorahovac-kosovo-4th-december-2010-the-initiative-for-rekom/>

68 Në shtator të vitit 2003, kryetarët e Serbisë, Malit të Zi dhe Kroacisë, Svetozar Marović dhe Stjepan Mesić respektivisht, shkëmbyen kërkim faljet e tyre për të gjitha krimet e kryera. Presidenti serb Boris Tadiq ka kërkuar falje në emër të qytetarëve serbë në Sarajevë në vitin 2004 dhe në Zagreb në vitin 2007. Më 10 korrik 2010, ai vizitoi Qendrën Përkujtimore të Potoçarit. Në një talk show Intervistë të transmetuar në BHT boshnjake në prill 2013, Presidenti i Serbisë, Tomislav Nikoliq ka kërkuar falje për krimet ndaj boshnjakëve të kryera nga individët në emër të Serbisë dhe popullit serb. Asambleja Kombëtare e Republikës së Serbisë ka miratuar në mars të vitit 2010 Deklaratën që dënon krimet në Srebrenicë, dhe në tetor të po atij viti deklaratën që dënon të gjitha krimet kundër pjesëtarëve të popullit serb dhe qytetarëve serbë. Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, E drejta viktimave për dëmshpërblim në Serbi dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut standardeve 2014/2015 Raporti. Raporti. Belgrade, Serbia: Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, 2016. faqe 8

Rreth 2,197 serbë dhe 526 romë u vranë ose u raportuan të zhdukur pas rrëmbimeve që prej përfundimit të konfliktit.⁶⁹ Por, mizoritë masive të kryera nga regjimi serb për një periudhë më të gjatë se një dekadë, janë të pakrahasueshme dhe nuk mund të barazohen. Një njohje zyrtare e Qeverisë së Serbisë për krimet e fundit të kryera nga regjimi i mëparshëm do të kishin kontribuar në qetësimin e tensioneve dhe lehtësimin e klimës në mes të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës.

Historia na tregon se më 20 shtator 1952, Kancelari Adenauer nënshkruan marrëveshjen e Luksemburgut. Ai vendosi pajtimin me Izraelin dhe botën hebreje si detyrën më imediate dhe jetike të qeverisë së tij. Ai donte që Gjermania e re të rifitojë besimin e aleatëve perëndimorë dhe për të fituar një vend në Aleancën Perëndimore ndaj agresionit të mundshëm sovjetik.⁷⁰ Konrad Adenauer besonte se:

*"Reparacionet e Hollokaustit do të bindin komunitetin ndërkombëtar se Gjermania Perëndimore ishte tronditur nga e kaluara e vet naziste dhe mund t'i besohet autonomia politike"*⁷¹

Kancelari Adenauer ishte një udhëheqës vizionar, i cili pavarësisht kundërthënieve brenda qeverisë së atëhershme në lidhje me reparacionet për viktimat hebreje, vendosi për të përmirësuar pozicionin gjerman në arenën ndërkombëtare, dhe për të shënuar ndërprerjen e krimeve të fundit nën nazistët.

Serbia në anën tjetër, nuk ishte formalisht në një "gjendje lufte", me përjashtim gjatë sulmeve ajrore të NATO-s, megjithatë, ajo ka luajtur një rol aktiv në konfliktet e armatosura në ish-Jugosllavi. Qeveria e Serbisë ende nuk ka heqë dorë nga pretendimi i saj në Kosovë, jo vetëm duke mos e njohur atë, por Kosova mbetet si pjesë e Kushtetutës së Serbisë, dhe Serbia nuk ka ofruar as falje simbolike, as dëmshpërblim për dhunën shtetërore të shkaktuar ndaj popullsisë së Kosovës para dhe gjatë konfliktit të armatosur.

5.1. Kompensimet

Ndërsa reparacionet për dëmet e luftës në Kosovë, si njerëzore, ekonomike dhe pronësore duhet të hetohen mirë, të dokumentohen dhe të vlerësohen para se zyrtarët të jenë në gjendje për të kërkuar llogaridhënie nga Serbia, është koha e duhur që të kërkohen kompensimet për borxhet e papaguara për pensionistët. Katër vjet pas përfundimit të konfliktit të armatosur, në fund të vitit 1999, Kroacia përfundoi hetimin dhe dokumentimin për të ngritë një padi kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (ndryshuar më vonë në Unionin Serbi-Mali i Zi) në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) për gjenocid, e ku kërkoi kompensim për dëmet e luftës.⁷² Në fillim të shkurtit 2015, gjykata më e lartë e Kombeve të Bashkuara vendosi që as Kroacia dhe

69 Human Rights Watch, 2001. <https://www.hrw.org/reports/2001/kosovo/undword2c.html>

70 Balabkins, Nikolas. *West German Reparations to Israel*. 1971. faqe.142 – 153

71 Posner, Eric A. "Reparations for Slavery and Other Historical Injustices." *Chicago Unbound*, 2003, 694.

72 Vukic, Ina. "Croatia: Reparations for War Damages – A Priority in Relating To Serbia." April 26, 2015. <http://inavukic.com/2015/04/26/croatia-reparations-for-war-damages-a-priority-in-relating-to-serbia/>.

as Serbia nuk ka kryer gjenocid ndaj popujve të njëri-tjetrit, në luftërat gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, prandaj, përfundimi ishte se nuk duhet të paguhen reparacione.

Institucionet e Kosovës, në anën tjetër, janë shumë prapa në dokumentimin e së kaluarës, në mënyrë që të jenë në gjendje të paraqesin një padi kundër Serbisë. Hetimi dhe dokumentimi i humbjeve njerëzore është finalizuar kryesisht nga OJQ-të e specializuara në fushën e hetimeve të krimeve të luftës. Por, humbjet ekonomike dhe pronësore ende duhet hulumtuar mirë dhe dokumentuar para se të negociohen. Shtetet e reja të ish-Jugosllavisë nuk i kanë korrigjuar vet padrejtësitë e kaluara duke ndjekur kriminelët, as që kanë bërë përpjekje për të rivendosur dinjitetin e viktimave.

Megjithatë, Kosova mbetet rast unik në këtë çështje, meqë shembuj të ngjashëm nuk mund të nxirren nga Marrëveshja për Çështjet e Suksesionit ndërmjet shteteve pasuese të ish-Jugosllavisë, por disa shembuj të mirë për reparacione në konfiskimin e pronës nga Evropa Lindore mund të na ndihmojnë si një pikënisje. Vala e fundit e reparacioneve që ndodhi në Evropën Lindore u ngrit me fundin e Luftës së Ftohtë. Këto reparacione nuk synonin për të rehabilituar viktimat dhe të mbijetuarit e një konflikti të armatosur, siç është rasti me vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto reparacione u zhvilluan në shtetet e reja demokratike, si Republika e Çekisë apo Gjermania Lindore, ku prona të qytetarëve të saj ishin konfiskuar nga qeveritë komuniste. Më pas, qytetarët kërkuan kthimin e kësaj pasurie ose kompensim. Të dy vendet janë të njohura për programet më të shquara të reparacioneve. Të dy skemat e reparacioneve, gjermano lindore dhe çeke janë dizajnuar në atë mënyrë që lejojnë fëmijët e viktimave të shpronësimit për të kërkuar kthimin e pronës. Asnjë regjim nuk bën dëm pa i ditur pasojat e krimeve të veta ndaj popullit të vet. Kur qeveritë komuniste të vendeve të përmendura më lart shpronësuan tokën, ato e dinin fare mirë se ishin dëmtuar fëmijët e pronarëve të pronës, si dhe vetë pronarët, duke supozuar se fëmijët kanë një të drejtë bazë për të trashëguar pronën nga prindërit e tyre.⁷³ Këto qeveri përkatëse, si dhe të tjerat para LPB dhe pas LDB janë gjithashtu për t'u fajësuar, sepse mund të kishin vepruar ndryshe, dhe nuk vepruan. Si pasojë, ato i detyrohen pasardhësve, sepse është dashtë të parashikonin se pasardhësit do të lëndohen nga dëmtimi i pronarëve të pronës origjinale."⁷⁴

Autoritetet FSPI të Serbisë fillimisht kanë justifikuar ndërprerjen e pagesës së pensioneve me pamundësinë e mbledhjes së kontributeve në Kosovë. Kjo tregon mungesën e vendosmërisë nga ana e Serbisë për të zgjidhur një çështje që do të mbetet pengesë e fortë në të ardhmen e marrëdhënieve mes dy vendeve. Sipas fjalëve të juristit të njohur të Kosovës Adil Fetahu: "*Kur ky arsyetim ishte hedhur poshtë për mungesë të argumentimit ligjor nga vet Gjykata Supreme e Serbisë, si dhe nga Gjykata e Strasburgut, atëherë ndërprerja e pagesës së pensioneve ishte "justifikuar" me pamundësinë e marrjes së dy pensioneve "në Republikën e Serbisë."*⁷⁵

73 Posner, Eric A. "Reparations for Slavery and Other Historical Injustices." *Chicago Unbound*, 2003, faqe 695.

74 Ibid, faqe 700.

75 Fetahu, Adil. "Serbia Po Manipulon Me Pensionet E Pensionisteve Kosovare (Serbia Is Manipulating with the Pension Funds of Kosovo)." *Zemra Shqiptare*. 22 shkurt 2013. http://www.zemrashqiptare.net/news/id_31091/Adil-Fetahu:-Serbia-abuzon-me-pensionet.html

Serbia ka treguar gatishmërinë e saj për t'u bërë anëtare e BE-së, dhe kështu do të kërkohej që të respektojë standardet demokratike për t'u anëtarësuar. Një prej këtyre standardeve është respektimi i marrëveshjeve të nënshkruara sipas Marrëveshjes për Normalizimin e Marrëdhënive me fqinjët. Duke ndryshuar legjislacionin në favor të vet, dhe duke e trajtuar Kosovën, ende, si pjesë të Serbisë, në përputhje me preambulën e Kushtetutës së Kosovës, Beogradi zyrtar nuk konsideron se përfitimet që qytetarët e Kosovës marrin që nga fundi i konfliktit në vitin 1999 nga buxheti i konsoliduar i Kosovës nuk janë në fakt pensione, por pjesë e një skeme të përfitimeve financiare për qytetarët e një moshe të caktuar të Kosovës (Fetahu 2015).

Për të përfunduar, normalizimi i marrëdhënive me fqinjët nuk mund të bëhet pa u marrë me trashëgiminë e së kaluarës së dhunshme, dhe drejtësia transicionale është zakonisht në qendër të politikës për reparacione.

6. Përmbyllje

Qëllimi i këtij punimi nuk ka qenë për të justifikuar mungesën e iniciativave të viktimave dhe të mbijetuarve të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit për të sfiduar gjykatat serbe në realizimin e drejtësisë dhe reparacioneve si pasojë e konfliktit në Kosovë. Po ashtu, ky punim nuk ka për qëllim të dekurajojë të mbijetuarit e krimeve të luftës për të provuar përsëri. Megjithatë, ideja është që të inkurajohen kosovarët të cilëve u janë abuzuar të drejtat ekonomike dhe pronësore në vitet '90, për të kërkuar drejtësi nga shteti serb, dhe për të shtjerrë të gjitha mekanizmat ndërkombëtarë për ta detyruar Serbinë të kryejë reparacionet për kosovarët. Dialogu që po ndodhë mes Kosovës dhe Serbisë, jep shpresë se një lloj reparacioni mund të sigurohet. Kosova nuk mund ta bindë Serbinë të paguajë reparacionet për krimet e luftës dhe të ofrojë falje. Shtetet kryesisht vullnetarisht hyjnë në negociata për reparacione si rezultat i presionit, qoftë i butë apo shtrëngues, nga një grup i cili është i lidhur me lëvizjen për dëmshpërblim apo nga akterët ndërkombëtarë. Por, ajo që Kosova duhet të bëjë është të dokumentojë borxhet e papaguara për pensionistët, nga regjimi serb në vitin 1990-a, dhe të kërkojë dëmshpërblim në raundin e ardhshëm të dialogut.

Edhe pse Shtetet e Bashkuara dhe vendet tjera i kanë bërë presion Gjermanisë për të paguar reparacionet për viktimat e Holokaustit, rasti i Holokaustit dallon nga rastet e tjera të reparacioneve të detyruara të kohës së luftës. Ndërsa faktorët e jashtëm mund të përdoren për t'i bërë presion shtetit (shkelës) në negociata, koncepti i sovranitetit nënkupton se akterët e jashtëm nuk mund ta detyrojnë shtetin për veprime të brendshme. Kjo është e qartë nga fakti se në marrëdhëniet shtet-viktimë, viktimat janë në pozitë më të dobët. 76

Dëmshpërblimi vullnetar dhe reparacioni, shpesh është opsioni i vetëm që komunitetet e viktimizuara mund ta realizojnë drejtësinë, duke qenë e vetmja kornizë në dispozicion në të cilën mund të ndodhë pajtimi politik. Nëse shteti lirshëm pranon se ka gabuar, ai pranim ndihmon të sjellë përmbylljen dhe nxitë perceptimin se ka pak mundësi që të ndodhë

76 Wolfe, Stephanie. The Politics of Reparations and Apologies, Volume 7, Springer Science+Business Media New York 2014. faqe.60

përsëritja.⁷⁷ Duke pranuar që ka bërë gabim, Serbia nuk favorizon shqiptarët e Kosovës, përderisa kjo më shumë i sjell favore e të mira të mëdha vet Serbisë. Megjithatë, në shumë raste, derisa pranimi i tillë i krimeve nuk ndodhë, rrjedhimisht drejtësia nuk arrihet.

⁷⁷ Wolfe, Stephanie. *The Politics of Reparations and Apologies, Volume 7*, Springer Science+Business Media New York 2014. faqe.60

7. Bibliografia

Librat

Fetahu R. Adil, *Në mbrojtje të Drejtës dhe Drejtësisë*, Botim I autorit, Prishtinë, 2014

Greiff, Pablo De. "Dealing with the past and Transitional Justice Creating Conditions for Peace, Human Rights and the Rule of Law, 'Reparations and the Role of International Cooperation.

Maliqi, Shkelzen 2011. "Why the Peaceful Resistance Movement in Kosovo Failed ". Accessed in January 13, 2016.

Wills, Siobhan. *Protecting Civilians*, the Oxford University Press, 2009.

Wolfe, Stephanie. *The Politics of Reparations and Apologies*, Volume 7, Springer Science+Business Media New York 2014.

Intervistat

Intervista e autores me gratë, familjare të viktimave civile nga Rahoveci, Dhjetor 4, 2010.

Fokus Grup

Një fokus grup i organizuar nga CRDP më 5 Prill 2016 me pjesëmarrësit nga këto institucione: Sindikata e Pensionistëve të Kosovës, Lidhja e Pensionistëve të Kosovës, Federata e Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës, Gratë Pensioniste; përfaqësues, një avokat dhe ekspertë të pensioneve.

Artikujt Akademik

Balabkins, Nikolas. *West German Reparations to Israel*. 1971. Pg.142 – 153.

Cunningham, Michael. *Saying Sorry: The Politics of Apology*, the Political Quarterly Publishing Co. Ltd, 1999, pp 291.

Pula, Besnik. "The Emergence of the Kosovo "parallel State," 1988–1992." *The Journal of Nationalism and Ethnicity*, 2004th ser., 32, no. 4 (January 23, 2007). <http://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/0090599042000296131>.

Posner, Eric A. "Reparations for Slavery and Other Historical Injustices." *Chicago Unbound*, 2003, 689.

Artikuj në Revista

Fetahu, Adil. "Serbia Po Manipulon Me Pensionet E Pensionistëve Kosovare (Serbia Is Manipulating with the Pension Funds of Kosovo." *Zemra Shqiptare*. February 22, 2013. http://www.zemrashqiptare.net/news/id_31091/Adil-Fetahu:-Serbia-abuzon-me-pensionet.html

Llashtica, Liridon. "Serbia 2 Miliardë Euro Borxh Pensionistëve (Serbia Owns 2 Billion Euros to Pensioners)." *Zeri.info*, January 8, 2014. <http://old.zeri.info/artikulli/24366/undefined>.

Selmanaj, Ibrahim. "Issue of Kosovar Pension and Invalid Fund Misappropriated by Serbia Must Be Resolved." Albanian-Serbian Information Exchange Forum. <http://kosovakosovo.org/issue-of-kosovar-pension-and-invalid-fund-misappropriated-by-serbia-must-be-resolved.html>.

Vukic, Ina. "Croatia: Reparations for War Damages – A Priority in Relating To Serbia." April 26, 2015. <http://inavukic.com/2015/04/26/croatia-reparations-for-war-damages-a-priority-in-relating-to-serbia/>.

"Women in Black, Apologize Albanians from Belgrade Center." *Kosova Press*, March 26, 2014. <http://www.kosovapress.com/en/nacional/women-in-black-apologize-albanians-from-belgrade-center-13410/>.

Raportet

Belgrade, *Victims' Right to Reparation in Serbia and the European Court of Human Rights Standards 2014/2015 Report*. Report. Belgrade, Serbia: Humanitarian Law Center, 2016. Pp8

Centre for Research, Documentation and Publication (CRDP). *Monitoring of Law No. 4/L-054 "On The Status And The Rights of the Martyrs, Invalids, Veterans, Members of Kosovo Liberation Army, Civilian Victims of War and Their Families"*. Prishtina: CRDP, 2014. pg.57.

Centre for Research, Documentation and Publication (CRDP). *Needs Assessment of Kosovo Victims*. Publication. Pristina: CRDP, 2012

Dixon, Peter J. "Reparations, Assistance and the Experience of Justice: Lessons from Colombia and the Democratic Republic of the Congo." *IJTJ International Journal of Transitional Justice*, 2015. <http://ijtj.oxfordjournals.org/content/early/2015/12/28/ijtj.ijv031.abstract>.

Ellis, Mark S., and Elizabeth Hutton. "Policy Implications of World War II Reparations and Restitution as Applied to the Former Yugoslavia." *Berkeley Journal of International Law* 20.

Fetahu, Adil. "E Drekjta per Reparacione, apo Kerkim Falje", Prishtine, 5 Prill 2016

Gubbels, John, David Snelbecker, and Lena Zezulin. *The Kosovo Pension Reform: Achievements and Lessons. Report*. World Bank Accessed in February 13.2016. Pp.12

<http://siteresources.worldbank.org/SOCIALPROTECTION/Resources/SP-Discussion-papers/Pensions-DP/0707.pdf>

Loxha, Arbëresha, Policy Report 06/2012 Pension System in Kosovo: Review of Current State, Main Challenges and Gaps, Group for Legal and Political Studies, December 2012

Uebfaqet

Grudić v. Serbia, No. 31925/08 (The European Court of Human Rights April 17, 2012) (Dist. file).http://www.zastupnik.gov.rs/uploads/cr/presude/u-odnosu-na-rs/grudic-protiv-srbije-p-br.-31925-08/Grudic_p_3192508_eng.pdf

Human Rights Watch, 2001. <https://www.hrw.org/reports/2001/kosovo/undword2c.html>

Krasniqi, Tome. The Human Rights Advisory Panel, sitting on 6 June, Date of adoption: 6 June 2013 Case No. 08/10 2013, Accessed February 15.2016 http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Cases%20Eng/DC_08-10_ENG.pdf

Law No. 04/L-054, Kosovo Assembly Cong. (2011) (enacted)

Law No. 04/L-261, Kosovo Assembly, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-261 a.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-261%20a.pdf) (2014) Kosovo Assembly (enacted)

“Order for Reparations.” International Criminal Court:

<https://www.icc-cpi.int/iccdocs/doc/doc1919026.pdf>

“ORDER FOR REPARATIONS (AMMENDED).” A PRINCIPLES ON REPARATIONS. Accessed January 17.2016.
ICC-01/04-01/06-3129-AnxA 03-03-2015 1/20 NM A A2 A3

Permanent Representative of Portugal to the United Nations." Letter to President of the Security Council. May 18, 2012. New York.
<http://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/N1235537.pdf>

United Nations. General Assembly. *Basic Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law*. 60/147 ed. Vol. Resolution.
<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RemedyAndReparation.aspx>. Accessed on February 2.2016.